



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 26/4 prot.

Tiranë më 15.9.2017

URDHËR

Nr. 28, datë 15.9.2017

PËR

**SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE, TË CILAT KANË
TEJKALUAR AFATIN LIGJOR TË PËRPUNIMIT.**

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 29 dhe 30 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.161, datë 15.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë.

Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, është subjekt juridik me NIPT: K81505451M dhe aktivitet shërbimin e përkujdesit rezidencial për gra dhe vajza të dhunuara. Ky kontrollues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave "punëmarrës" e "përfituese".

Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, në ushtrim të detyrës që realizon mbledh një gamë të dhënash personale për subjektet e të dhënave "përfituese", si: gjeneralitete, dhe më së shumti të dhëna personale sensitive, duke filluar që nga formulari i pranimit, duke vazhduar me një sërë formularësh për: vlerësimin shëndetësor, vlerësimin ligjor, vlerësimin psiko-social, vlerësimin financiar, vlerësimin e nevojave arsimore profesionale, vlerësimin e riskut, llojet e dhunës të përjetuar, besimin fetar, sigurinë, akomodimin, punësimin, marrëdhëniet familjare, monitorimin afat-gjatë pas daljes nga qendra pritëse etj.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, nuk ka kryer detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.
Konstatimi i pikës 1 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, ka rregullore formale për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas standardit gjithpërfshirës publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit, si e tillë, e pa përshtatur në funksion të veprimtarisë së kontrolluesit.
Konstatimi i pikës 2 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, në formularët tip të pranimit, "*Të dhëna mbi rastin*" mbledh të dhëna sensitive "*Besimi fetar*", e dhënë e cila në kuptim të nenit 5 gërma "c" e tejkalon qëllimin e përpunimit.
Konstatimi i pikës 3 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 5 gërma "c" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, në arkivën e tij, ka të grumbulluara dosje të cilat datojnë që në fillimet e veprimtarisë së tij, viti 1992.
Konstatimi i pikës 4 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 5 gërma "d" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar:

"1.Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej".

Pika 4 e procesverballit, konsiston në mbajtjen e dosjeve me të dhëna personale sensitive të përfitueseve, më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Këto dosje, përmbajnë të dhëna me karakter sensitiv vetjak, duke cenuar jetën private dhe intime të përfitueseve.

Zyra e Komisionerit pas përfundimit të procedurës së kontrollit ka dalë me aktin rekomandues, Nr.34 datë 25.07.2017, në lidhje me shkeljet e konstatuara sipas pikave të procesverballit të mësipërm, ku ndër të tjera shprehet:

Në zbatim të nenit 5, germa "d" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, i cili shprehet:

"1.Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej", kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, të parashikojë në rregulloren për "*Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale*", afatet ligjore të ruajtjes së të dhënave personale (dosjet) e përfitueseve".

Neni 3 "Përkufizime", pika 4 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përcakton se:

"Të dhëna sensitive" është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale".

Në konsultimet paraprake që Zyra e Komisionerit ka zhvilluar me palët e interesuara, është konkluduar se afati i mbajtjes së dosjeve të "përfitueseve" nuk duhet të jetë më shumë se 10 vjet nga dalja e "përfitueseve" prej qendrës, duke marrë parasysh dhe monitorimin afatgjatë të tyre pas daljes nga qendra e trajtimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, sidomos kur është fjala për të dhënat sensitive të individëve, përpunimi i paligjshëm i të cilave sjell pasojë të pariparueshme të jetës dhe privatësisë së tyre.

Neni 30, paragrafi 1, gërma "b" e ligjit të sipërcituar përcakton se:

"Komisioneri ka këto të drejta:

b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale".

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 7, 29, 30 pika 1, germa "b" dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, pezullimin e përpunimit të të dhënave personale sensitive (dosjet) e subjekteve të të dhënave, kategoria "përfituese", që kanë mbi 10 vjet nga përfundimi i qëllimit për të cilin janë mbledhur.
2. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, të parashikojë në rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale", afatin 10 vjeçar të mbajtjes së dosjeve të "përfitueseve", pas daljes së tyre nga qendra e trajtimit.
3. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, të realizojë seleksionimin e dosjeve që disponon, deri në klasifikimin dhe verifikimin e saktë të tyre si:
 - a. Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në përputhje me afatet ligjore.
 - b. **Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në shkelje të afateve ligjore.**
4. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, pasi të ketë vepruar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhri, brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditore të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale sensitive (dosje) të arkivuara në kundërshtim me afatet ligjore.
5. Kontrolluesi *Strehëza për Gra dhe Vajza* Tiranë, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 60 ditëve.

6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më, 15/9/2017

